

Në përputhje me nenin 24 paragrafi 2 të ligjit “Për kontrollin e tregtisë së jashtme të mallrave dhe shërbimeve të rëndësisë strategjike për sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës” (“Fletorja zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës, numër 103/09) dhe nenin 61 paragrafi 2 të ligjit “Për administratën publike” (“Fletorja zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës, numër 32/02 dhe 102/9), Ministri i Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike miraton:

UDHËZIMIN

PËR MBIKËQYRJEN E SUBJEKTEVE JURIDIKE DHE PERSONAVE FIZIKË TË CILËVE U JANË LËSHUAR DOKUMENTE OSE QË JANË REGJISTRUAR PËR KRYERJEN E TREGTISË SË JASHTME TË MALLRAVE NGA LISTAT E KONTROLLIT

Neni 1. (Objekti)

Ky Udhëzim për mbikëqyrjen e subjekteve juridike dhe personave fizikë të cilëve u janë lëshuar dokumente ose që janë regjistruar për kryerjen e tregtisë së jashtme të mallrave nga listat e kontrollit (në vijim referuar si: Udhëzimi) përcakton qëllimin dhe procedurën e realizimit të mbikëqyrjes mbi subjektet juridike dhe personat fizikë të cilëve u janë lëshuar dokumente për tregtinë me jashtë, certifikata e përdoruesit final ose që është regjistruar për tregtinë me jashtë të mallrave nga listat e kontrollit, në përputhje me ligjin “Për kontrollin e tregtisë së jashtme të mallrave dhe shërbimeve të rëndësisë strategjike për sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës” (“Fletorja zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës, numër 103/09), (në vijim referuar si: Ligji).

Neni 2. (Përkufizimet)

Termtat e përdorura në këtë Udhëzim kanë të njëjtat kuptime si termtat e përdorura në ligji.

Neni 3. (Qëllimi i mbikëqyrjes)

Mbikëqyrja përfshin:

- a) kontrollin e brendshëm të respektimit të rregulloreve nga ana e subjektit juridik, si përdoruesi i dokumentit për tregtinë me jashtë ose subjektit juridik të regjistruar për kryerjen e tregtisë me jashtë të mallrave nga listat e kontrollit dhe të shërbimeve të lidhura me to;
- b) mbikëqyrja ushtrohet nga organet kompetente kantonale ose të entiteteve, të cilat kanë lëshuar dokumentin që miraton ose përcakton qëllimin e importit të mallrave nga listat e kontrollit në bazë të të cilit është lëshuar edhe dokumenti për tregtinë me jashtë;
- c) mbikëqyrja e realizimit të dokumenteve të lëshuara për tregtinë me jashtë kryhet nga zyrtarët e Ministrisë së Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike e Bosnjë-Hercegovinës (në vijim referuar si: Ministria) të cilët kanë lëshuar dokumentet që janë objekt i mbikëqyrjes;
- d) mbikëqyrja emergjente, e cila ushtrohet vetëm në raste të veçanta, kryhet nga ekipi mbikëqyrës të cilin e formon Ministri i Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike.

Neni 4. (Kontrolli i brendshëm i subjektit juridik që është përdorues i dokumentit)

Kontrolli i brendshëm për respektimin e rregulloreve nga ana e subjektit juridik i cili është përdoruesi i dokumentit për tregtinë me jashtë ose subjektit juridik të regjistruar për kryerjen e tregtisë me jashtë të mallrave nga listat e kontrollit dhe të shërbimeve të lidhura me to, siguron mekanizmat për ngritjen e ndërgjegjësimit ndërmjet prodhuesve dhe shoqërive tregtare dhe përfaqëson një element të rëndësishëm në zbatimin e ligjit.

Neni 5.

(Mbikëqyrja e kryer nga organet kompetente kantonale dhe të entiteteve)

Organet kantonale ose të entiteteve të cilët kanë lëshuar dokumentin me të cilin miratohet ose përcaktohet qëllimi i importit të mallrave nga listat e kontrollit bazuar në të cilin është lëshuar dhe dokumenti për tregtinë me jashtë, ushtrojnë mbikëqyrje në përputhje me rregulloret kantonale ose të entiteteve brenda kuadrit të kompetencave të tyre.

Neni 6.

(Mbikëqyrja e realizimit të dokumenteve të lëshuara për tregtinë me jashtë)

- (1) Mbikëqyrja e realizimit të dokumenteve të lëshuara për tregtinë me jashtë përfshin:
 - a) kontrollin e raporteve për realizimin e dokumenteve bashkë me dokumentacionin shoqëruar (deklaratën e personit përgjegjës të dokumenteve për realizimin e dokumentit, vërtetimin e përdoruesit final që malli në dokument ka mbërritur në destinacionin final dhe kopjen e dokumentit të realizuar), të cilat përdoruesi i dokumentit i dorëzon në Ministri brenda 15 ditëve nga dita e realizimit dhe hedhjes së të dhënave për realizimin e dokumentit në regjistrin e dokumenteve që mbahet nga Ministria;
 - b) kontrollin e mbajtjes së regjistrave që përdoruesi i dokumentit është i detyruar t'i mbajë në përputhje me nenin 23 të ligjit;
 - c) mbikëqyrjen e përdorimit të licencës së përgjithshme, e cila nënkupton kontrollin e raportimit të detyrueshëm tremujor për përdorimin e licencës, këqyrjen e dokumentacionit dhe kontrollin e mbajtjes së regjistrave dhe, sipas nevojës, vizita periodike në ambientet e përdoruesit të licencës së përgjithshme.
- (2) Për mbikëqyrjen e realizuar të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mbahet procesverbal.
- (3) Në rast të shkeljeve të evidentuara të dispozitave të ligjit, do të ndërmerret një procedurë për zbatimin e mbikëqyrjes emergjente.

Neni 7.

(Mbikëqyrja emergjente)

- (1) Mbikëqyrja emergjente ushtrohet në rastet vijuese:
 - d) nëse gjatë realizimit të mbikëqyrjes të përmendur në nenin 6 të këtij Udhëzimi janë vërejtur shkelje të dispozitave të neneve 21 dhe 23 të këtij ligji;
 - e) nëse disponohen informacione mbi fakte në bazë të të cilave nuk do të ishte e mundur të kryhej regjistrimi i personave në Regjistër, nëse këto fakte kanë qenë të njohura në momentin e regjistrimit në Regjistrin e tregtisë me jashtë;
 - f) nëse rezulton se dokumenti i tregtisë me jashtë është lëshuar në bazë të të dhënave të pasakta ose të paplota;
 - g) nëse disponohen të dhëna të reja të cilat, nëse do të ishin ditur në kohën e shqyrtimit të kërkesës për lëshimin e dokumentit, do të çonin në refuzimin e kërkesës për lëshimin e dokumentit;
 - h) nëse konstatohet se dokumenti i lëshuar nuk përdoret për qëllimin e caktuar;
 - i) nëse gjatë mbikëqyrjes paraprake është urdhëruar zbatimi i masave të caktuara shtrënguese
- (2) Mbikëqyrja emergjente realizohet nga ekipi mbikëqyrës që krijohet me vendim të Ministrit për Tregtinë e Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike. Gjatë krijimit të ekipit mbikëqyrës merret

parasysh veçanërisht lloji i tregtisë së jashtme dhe klasifikimi i mallrave dhe shërbimeve të përmendura në dokumentin për tregtinë me jashtë, si dhe fushat e veprimtarisë së përdoruesit të dokumentit.

- (3) Në ekipin mbikëqyrës në nenin paraardhës emërohen zyrtarë të ministrisë, ose sipas nevojës dhe nëpunës shtetërorë nga organet e tjera kompetente për rastin konkret të mbikëqyrjes.
- (4) Në ekipin mbikëqyrës emërohen nëpunës shtetërorë nga Inspektorati i Ministrisë ose Sektori për rregullimin e prodhimit të armëve nëse mbikëqyrja kryhet ndaj një subjekti juridik të cilit i është lëshuar leja për prodhimin dhe riparimin e armëve dhe pajisjeve ushtarake.
- (5) Në rast se për zbatimin e mbikëqyrjes nevojiten njohuri profesionale specifike, në këtë ekip mund të përfshihen persona nga institucionet e specializuara.
- (6) Mbi mbikëqyrjen emergjente të realizuar mbahet procesverbal. Nëse vihen re shkelje të ligjit dhe dispozitave të tjera, ekipi mbikëqyrës jep një afat për ndreqjen e tyre dhe urdhëron masa në përputhje me dispozitat e ligjit.

Neni 8.
(Mundësimi i mbikëqyrjes)

- (1) Subjektet juridike dhe personat fizikë të cilëve u janë lëshuar dokumentet për tregtinë me jashtë, certifikata e përdoruesit final ose që janë regjistruar për kryerjen e tregtisë me jashtë janë të detyruar që t'i mundësojnë ekipit mbikëqyrës kryerjen e mbikëqyrjes dhe t'i paraqesin dokumentet dhe të dhënat e kërkuara.
- (2) Në rast pamundësimi të zbatimit të mbikëqyrjes do të vepohet në përputhje me dispozitat e nenit 19 paragrafi 1 pika e dhe nenit 25 paragrafi 2 pika a e këtij ligji.

Neni 9
(Hyrja në fuqi)

Ky Udhëzim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit të tij në “Fletoren zyrtare të Bosnjë-Hercegovinës”⁷

Numër 07-01-02-1179/10
26 mars 2010
Sarajevë

Ministri
Mladen Zirojević, nënshkrimi